

KËRKESË PËR INFORMACION

Tiranë, më 27.01.2023

Drejtuar: Z. Genti Gazheli
Drejtor
Drejtori i Përgjithshëm i Doganave
Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km
1, Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Nga: Znj. R..... M.....
Gazetare

Lënda: Kërkesë për informim

I Nderuar Z.Gazheli,

Bazuar në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” po paraqes këtë Kërkesë për informim me anë të së cilës kërkoj të informohem, në mënyrë të detajuar dhe të saktë, për çështjet si vijon:

1. Sa është vlera në lek ose euro e barnave të kontrabanduara të sekuestruara nga Shërbimi Doganor Shqiptar për vitin 2020?
2. Sa është vlera në lek ose euro e barnave të kontrabanduara të sekuestruara nga Shërbimi Doganor Shqiptar për vitin 2021?
3. Sa është vlera në lek ose euro e barnave të kontrabanduara të sekuestruara nga Shërbimi Doganor Shqiptar për vitin 2022?
4. Sa është vlera e ilaçeve të importuara përgjatë vitit 2020?
5. Sa është vlera e ilaçeve të importuara përgjatë vitit 2021?
6. Sa është vlera e ilaçeve të importuara përgjatë vitit 2022?
7. Cilat janë 10 vendet kryesore nga të cilët Shqipëria importon ilaçe?

Kjo Kërkesë për informim plotëson të gjitha kriteret që parashikohen në nenet 11 e vijues, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Në mungesë të një përgjigjeje mbi këtë Kërkesë, mund të paraqes ankim administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda afatit ligjor të përcaktuar në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, mbetem në pritje të përgjigjes tuaj.
Me konsideratë,

R..... M.....
Gazetare